

V E N D I M
Nr. 287, datë 2.6.2000

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.250, DATË 16.4.1996, “PËR PROCEDURAT DHE PRIORITETET NË ZBATIM TË LIGJIT NR.8030, DATË 15.11.1996, “PËR KONTRIBUTIN E SHTETIT PËR FAMILJET E PASTREHA””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, neni 13, me propozimin e ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.250, datë 16.4.1996, “Për procedurat dhe prioritetet në zbatim të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, pika 18 ndryshon si vijon:

- Ngarkohet Enti Kombëtar i Banesave, që në fund të çdo viti, t’i paraqesë për miratim Këshillit të Ministrave, vlefën mesatare vjetore të apartamenteve tip të tregut të lirë në shkallë rrethi. Këto të dhëna do të nxirren sipas shitblerjeve të apartamenteve tip të privatizuara, që bën Enti Kombëtar i Banesave në tregun e lirë të tyre. Vlefë mesatare vjetore do të paraqitet në lek/m² sipërfaqe banimi dhe do të përdoret në zbatim të ligjit për vitin pasardhës.

- Të dhënat do të nxirren sipas blerjeve që bën Enti Kombëtar i Banesave në tregun e lirë të banesave.

- Përcaktimi i vlerës reale të tregut të lirë të banesave do të bëhet në bazë të blerjeve të apartamenteve që bën Enti Kombëtar i Banesave në atë rreth.

- Vlera reale e një sipërfaqeje banimi është e barabartë me vlerën reale të apartamentit në raport me sipërfaqen e banimit. Ajo do të nxirret nga raporti i vlerës mesatare aritmetike të ofertave me sipërfaqen e çdo apartamenti. Në vlerën reale përfshihet edhe sipërfaqja e truallit ku ndodhet apartamenti.

Në ato qytete (bashki e komuna) ku gjatë një viti bëhen blerje, vlefë e tregut do të merret ajo e një viti më parë e miratuar nga Këshilli i Ministrave, ose do të përcaktohet në analogji me ato qytete që kanë afërsisht një vlerë tregu, duke e krahasuar atë, me atë të një viti më parë, por gjithmonë i miratuar nga Këshilli i Ministrave.

- Drejtoria Rajonale dhe degët e Entit Kombëtar të Banesave nëpër prefektura e qytete do të dërgojnë çdo fillim të muajit janar të vitit pasardhës në Drejtorinë e Përgjithshme të Entit Kombëtar të Banesave, formularin nr.1 bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

FORMULARI NR.1

Treguesit kryesorë të banesës:

- Adresa e banesës
- Viti i ndërtimit
- Tipi i banesës dhe lloji i konstruksionit
- Sipërfaqja e banesës (banimit) dhe numri i ambienteve
- Vlefë totale
- Vlefë e llogaritur në lek/m² sipërfaqe banimi